



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/77

Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Kambialin dhe Premtim Pagesën.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Drejtësisë*  
*Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

**KONCEPT - DOKUMENTI**  
**PËR KAMBIALIN DHE PREMTIM-PAGESËN**

**Mars 2018**

# Koncept Dokumenti për Kambialin dhe Premtim- Pagesën

## Kapitulli 1: Hyrje

Sekretariati Koordinues i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka publikuar listën e koncept dokumenteve për vitin 2017, të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, në përputhje me Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Lista e koncept dokumenteve të aprovuara përfshinë Koncept Dokumentin për Kambialin dhe Premtim Pagesën.

Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019, e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në Maj 2014, përcakton si objektivë strategjike, 1 - Përmirësimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe paanshmërisë së sistemit të drejtësisë, ku si nën-objektivë përcaktohet përmirësimi i drejtësisë civile. Në kuadër të drejtësisë civile, ligji për marrëdhëniet e detyrimeve dhe ligji për procedurën përbarimore trajtojnë sipërfaqësisht edhe kambialin, i cili nuk është i rregulluar me këto ligje dhe për të cilin kërkohet trajtimi i veçantë.

Për shkak se Kambiali është instrument financiar, i cili përfshihet në kuadër të marrëdhënieve të detyrimeve, Ministria e Drejtësisë ka konsultuar një grumbull të përfituesve të mundshëm, përfshirë institucionet financiare dhe institucionet financiare jobankare mbi nevojën e rregullimit të këtij instrumenti me ligj dhe përfitimet që do t'i kishte ofrimi i një instrumenti të tillë në Kosovë. Për shkak se Kambiali është një instrument financiare që përdoret kryesisht për financim të bizneseve, dhe kërkesës së një numri të institucioneve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që të kenë kornizën ligjore të përshtatshme për ofrimin e kambialeve, Ministria e Drejtësisë ka filluar përgatitjet për krijimin e grupeve të ekspertëve për adresimin e kësaj çështje.

Kambiali dhe Premtimpagesa, përveç që përmbushin një pjesë të objektivave të Ministrisë së Drejtësisë për përmirësimin e drejtësisë civile në Kosovë, në të njëjtën kohë kontribuojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes dhe ngritjen e ranikimit të Kosovës në Raportin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore. Për shkak se Kambiali dhe Premtim Pagesa janë instrumente financiare të përshtatshme për kreditime të shpejta dhe janë lehtësisht të përbarueshme, si rezultat i rregullimit të këtyre fushave

pritet që Kosova të ketë përmirësime në rankimin e indikatorëve 'Qasja në Financa' dhe 'Përmbartimi i Kontratave'.

## **Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor**

Kambiali është letër me vlerë, dhe hyn në kategori të letrave me vlerë sipas urdhrorit, me të cilën lëshuesi i saj obligohet që t'ia paguaj ndonjë personi tjetër shumën e të hollave e cila është shënuar në kambial ose t'ia urdhër ndonjë personi tjetër kryerjen e pagesës. Një përkufizim i saktë mbi Kambialin nuk është i definuar në doktrinën juridike dhe shumica e ligjeve të aplikueshme në shtetet moderne fare nuk lëshohen në përkufizimin e tij, por rregullojnë përmbajtjen, mënyrën e lëshimit të kambialeve dhe përmbartimin e tyre. Kambiali si punë e pavarur formalo-juridike në mes të palëve, në Republikën e Kosovës nuk është e trajtuar me ligj, edhe pse aspekte të ndryshme të kambialit i ka trajtuar Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili njih ekzistencën e tyre dhe Ligji për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton mënyrat e përmbartimit të kambialit si dokument i besueshëm për qëllime të atij Ligji.

Në të kaluarën juridike të Kosovës, Kambiali është rregulluar me Ligj të veçantë në vitin 1946, "Ligji për Kambialin" i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Popullore të Jugosllavisë nr. 104/46 të datës 24.12.1946, i plotësuar dhe ndryshuar disa here radhazi deri në vitin 1989. Në periudhën pas viti 1999, nuk është hasur asnjë rast i zbatimit të këtij Ligji të vjetër, Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve nuk i referohet ligjit të vjetër mbi kambialin dhe përgjithësisht përdorimi i një ligji të tillë, përkundër që do të mund të konsiderohej i ligjshëm, është i papërshtatshëm për rrethanat aktuale.

Konventa e Gjenevës e vitit 1930 për sigurimin e Ligjit Unifikues për kambialin dhe premtim-pagesën është një instrument ndërkombëtar, i cili zbatohet për përpilimin e ligjeve të reja për kambialin dhe premtim pagesën. Një numër i konsiderueshëm i politikave dhe ligjeve rajonale gjithashtu ka trajtuar kambialin dhe i njëjti është në përdorim të gjerë në transaksione tregtare. Republika e Kosovës është e vetmja në rajon që ende nuk ka një ligj të veçantë për kambialin dhe si rezultat, kambiali nuk ofrohet si instrument nga institucionet financiare.

### ***Politika aktuale***

Aktualisht Kambiali dhe Premtimpagesa mbesin instrumente të pa-rregulluara në Republikën e Kosovës. Për shkak se të njëjtat janë instrumente financiare që rregullohen me parimet e të drejtës kontraktuese dhe janë shumë të ngjashme me çekun dhe letrat

tjera me vlerë, legjislacioni aktual në disa pjesë i referohet kambialeve (më shumë në pjesën "Ligjet dhe aktet nënligjore" të këtij Koncept Dokumenti).

Përgatitja e kornizës ligjore për rregullimin e Kambialit është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, sikurse e gjithë korniza ligjore e ndërlidhur me legjislacionin civil dhe obligatat. Për shkak se aspektet teknike të formës së Kambialit mund të ndryshojnë dhe masat e sigurisë të avancohen, këto çështje do të duhet të rregullohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ("BQK") me një akt nën-ligjor mbi formën e kambialit.

Përdoruesit kryesor të kambialit – institucionet financiare të licencuara nga BQK, që përfshijnë institucionet financiare bankare dhe institucionet financiare jo-bankare, një pjesë e të cilave e organizuar në kuadër të Shoqatës së Bankave të Kosovës ("SHBK") do të jenë pjesë e të gjithë procesit, nga përgatitja e këtij koncept dokumenti ku kanë qenë të përfaqësuara nga dy (2) anëtarë, e deri te përpilimi i Projektligjit për Kambialin. Ministria e Drejtësisë ka përfshirë në këtë proces edhe konsulentët e angazhuar nga USAID, përderisa Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("BERZH") ka shprehur gatishmërinë për të analizuar dhe ofruar rekomandimet e saj mbi Projektligjin mbi Kambialin dhe Premtim Pagesën dhe përputhshmërinë e tij me praktikën ndërkombëtare.

### *Ligjet dhe aktet nënligjore*

Përderisa nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon kambialin, përveç "Ligji për Kambialin", i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Popullore të Jugosllavisë nr. 104/46 të datës 24.12.1946, i plotësuar dhe ndryshuar disa here radhazi deri në vitin 1989, i cili nuk është zbatuar asnjëherë në Kosovë pas vitit 1999, një pjesë e ligjeve civile dhe procedurale i referohen kambialit ose përcaktojnë mënyrat e përmbartimit ndaj kambialit. Korniza aktuale ligjore që adreson çështje të ndërlidhura me Kambialin, por nuk e rregullon këtë instrument përfshinë:

1. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve;
2. Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore;
3. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118.
4. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton çështje të ndërlidhura me kambialin në disa pjesë të tij: vëllimi i autorizimeve (neni 79), dhënia e kambialit me qëllim të novacionit (neni 329) dhe fletëpengu pa dëftesë (neni 761). Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, përcakton kambialin si dokument të besueshëm në bazë të të cilit mund të kërkohet përmbartimi (neni

- 29), detyrimet e përmbushjes brenda tre ditëve në bazë të kambialit (neni 40 dhe 43) dhe dorëzimi i aktvendimit dhe urdhrit përmbarimor (neni 47).
5. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, përcakton kompetencën gjyqësore për poseduesit e kambialit (neni 50), afatet për përmbushje të premtimit në bazë të aktgjykimit kur është dhënë kambiali (neni 146), afatet e ankesës për aktgjykimet në bazë të kambialit (neni 176) dhe procedurat e dhënies së urdhërpagesës sipas kambialit (neni 493 dhe 495).

Përderisa kompetencat e gjykatave dhe organeve përmbaruese, si dhe disa detyrime në lidhje me kambialin janë të përcaktuara në tre (3) ligjet e theksuara më lartë, çështjet tjera përfshira dispozitat e përgjithshme, trajtimin e kambialit, përmbajtja e tij, nënshkrimi, xhirimi, pranimi, avali, maturimi i kambialit, amortizimi i kambialit, protesta dhe format uniforme të zbrazëta të kambialit dhe premtim-pagesa.

### *Programi aktual*

Aktualisht, korniza ligjore në Republikën e Kosovës nuk përcakton trajtimin e kambialit, përmbajtja e tij, nënshkrimi, xhirimi, pranimi, avali, maturimi i kambialit, amortizimi i kambialit, protesta dhe format uniforme të zbrazëta të kambialit dhe premtim-pagesa. Ligjet në fuqi rregullojnë disa çështje që kanë të bëjnë me kambialin, procedurat për kambialin në procedurë kontestimore dhe procedurat përmbarimore. Kornizës aktuale i mungon ligji organik i cili rregullon kambialin dhe premtim pagesën.

Mungesa e një instrumenti të tillë si kambialin në qarkullimin e mallrave në Kosovë paraqet një mangësi në numrin e instrumenteve financiare të ngjashme me kreditë, dhe në mungesë të saj bizneset obligohen që financimet e tyre t'i sigurojnë përmes procedurave më të gjata të kreditimit pranë institucioneve financiare. Me paraqitjen e këtij instrumenti, komunitetit të biznesit dhe qarkullimit tregtare në përgjithësi do t'u ofrohej një instrument i përshtatshëm përmes të cilit do të mund të financonin blerjet.

### *Vlerësimi plotësues i politikës aktuale*

Politika aktuale nuk rregullon çështjet substanciale që kanë të bëjnë me kambialin dhe premtim pagesën. Nuk ka asnjë ligj të nxjerr nga periudha e pas 1999 i cili rregullon çështjen e kambialit dhe premtim pagesës, përkundër që në disa ligje (Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve; Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118) përfshinë disa dispozita që kanë të bëjnë me çështjet procedurale civile dhe përmbartimore të kambialit. Si rezultat, përpilimi i Ligjit për Kambialin dhe Premtimpagesën sipas standardeve ndërkombëtare dhe në përputhje me Konventa e Gjenevës e vitit 1930 për sigurimin e Ligjit Unifikues për kambialin dhe premtim-pagesën është një instrument ndërkombëtar dhe praktikë më të mira rajonale dhe Evropiane do të mbulonte këtë zbrazëti në legjislacion dhe do të rregullonte përfundimisht kambialin si instrument.

### *Përvoja në shtetet tjera*

Kambiali është një ndër instrumentet më të vjetra të përdorura në qarkullimin e mallrave nga mesjeta e deri në ditët e sotshme. Gjatë historikut të zhvillimit të kambialit në shtetet e ndryshme të Evropës, janë dalluar tre sisteme: Sistemi Francez, Sistemi Gjerman dhe Sistemi Anglo-Sakson. Me qëllim të unifikimit të këtyre praktikave mbi kambialin, në vitin 1930, organizohet konferenca ndërkombëtare si rezultat i të cilës nxjerrët Konventa e Ligës së Kombeve mbi sigurimin e Ligjit Unifikues për kambialin dhe premtim-pagesën, instrument i cili edhe sot përdoret nga shtetet gjatë përgatitjes së ligjeve të reja për kambialin.

Kambiali si rregull trajtohet me ligje të veçanta, një traditë e ndjekur edhe nga shtetet e rajonit me histori të ngjashme juridike me Kosovën. Republika e Shqipërisë në vitin 1996 ka nxjerr Ligjin për kambialin dhe premtim-pagesën, i cili rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kambialin dhe premtim pagesën. Në Republikën e Maqedonisë, kambiali është instrument dukshëm më i përdorur se në vendet tjera të rajonit dhe gëzon një praktikë të suksesshme të përdorimit dhe përmbartimit nga organet përmbartuese. Për më tepër, në Maqedoni pjesë dërmuese e procedurave të kambialit janë procedura jashtë-gjyqësore të cilat rregullohen nga noteri dhe organi përmbartues privat, ngjashëm me përmbartuesit privat në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit për Kambialin të Republikës së Maqedonisë, kambiali është instrument i cili përdoret për kryerje të pagesës por edhe për sigurim të pagesës. Si rezultat, ky model është shumë i përshtatshëm për kushtet dhe nevojat e Kosovës. Parime të ngjashme me Ligjin për Kambialin e Republikës së Maqedonisë gjenden edhe te ligjet tjera të ish-Republikave Jugosllave, të cilat kanë trashëguar tradita të ngjashme juridike.

### **Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat**

#### *Synimi*

Synimi i përgjithshëm i politikës së kambialit dhe premtim pagesës është ofrimi i një instrumenti për kryerje të pagesave dhe sigurim të pagesave për komunitetin e biznesit, i cili do të kontribuonte në rritjen e qasjes në financa për sektorin privat dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

#### *Objektivat*

1. Krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për Kambialin, në përputhje me praktikat ndërkombëtare, i cili do të mundësonte ofrimin e kambialit si instrument nga institucionet financiare të Republikës së Kosovës, brenda periudhës së ardhshme dymbëdhjetë mujore.
2. Sigurimi i pagesave dhe kryerjes së pagesave nga relacionet e ndryshme kontraktuese në mes të sektorit privat, që do të ndikonin drejtpërdrejtë në qasjen më të mirë në financa, brenda njëzetekatër muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe akteve nënligjore.

### **Kapitulli 4: Opsionet**

#### *Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)*

*Status quo* është një opsion, i cili do të ndikonte edhe më tutje në mos-ofrimin e instrumentit të kambialit dhe premtim-pagesës nga institucionet financiare në Kosovë, për faktin se kambiali dhe premtim pagesa do të mbeteshin të pa rregulluara me ligj. Mungesa e kambialit do të ndikoj që bizneset edhe më tutje të kërkojnë forma tjera të financimit nga institucionet financiare, në formë të kredive, linjave kreditore, letër kredive dhe instrumenteve të ngjashme, të cilat për shkak të formës së tyre kanë procedura më të zgjatura të aprovimit, sigurimit të financimit dhe përfundimit procese



më të gjata përbarimore. Përderisa institucionet financiare i bazojnë llogaritjet e kamatës në rrezikun e kthimit dhe procedurat e nevojshme ligjore për përbarim të detyrimeve, mungesa e një instrumenti drejtpërdrejtë të përbarueshëm pranë organit përbarimor, me procedura të sigurta pranë noterit, nuk është inkurajuese për ofrimin e produkteve me norma atraktive në treg dhe rritjen e qasjes në financa për sektorin privat.

### *Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese*

Politika ekzistuese mund të ndryshoj vetëm me aprovimin e një Ligji të ri për kambialin dhe premtim pagesën, ligj modern i bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale, nga shtetet me sistem të ngjashëm juridik me Republikën e Kosovës. Përderisa Kosova ka krijuar sisteme efikase të noterisë dhe përbarimit privat, rregullimi i Kambialit tanimë është punë shumë më e lehtë.

Fushëveprimi i ligjit të ri do të përfshinte dispozita mbi krijimi e kambialeve, përcaktohen kambialet dhe premtim-pagesat, si dhe transaksionet e ndërlidhura gjatë veprimit me to. Ligji i ri do të përmbaj dispozita të veçanta sa i përket: Përmbajtjes së kambialit, kushtet e pagesës, garancitë e tërheqësit të pagesës, përfundimi kundër marrëveshjes, xhirimin dhe kushtet e xhirit, xhirimi në bosh, garancitë e xhiruesit, mosmarrëveshjet mbi xhirimin dhe pasojat ligjore të xhirit, pranimi dhe periudhat e pranimit, paraqitja, forma, përmbajtja dhe koha e pranimit, kufizimi i pranimit, adresa e pagesës, dështimi i pagesës, anulimi i pranimit, avali, forma dhe përmbajtja e avalit, dhënësi i një 'avali', maturimi, kambiali në shikim, kambiali i pagueshëm në një kohë të caktuar pas shikimit ose pas datës, koha e maturimit, pagesa, pagesa para maturimit, valuta e pagesës, mosparaqitja për pagesë brenda afatit kohor, të drejtat për shkak të mos-pagesës, protesta për mospranim ose mos-pagesë, njoftimi i mospranimit apo mos-pagesës, lirimi nga të pasurit e një proteste të mospranimit apo mos-pagesës, përgjegjësia, e drejta e kthimit, kthimi nga palët, kërkesat nga palët përgjegjëse, e drejta e kthimit pas një pranimit të pjesshëm, rihartimi, afatet kohore, zgjatja në afatet kohore, ndërhyrja dhe pranimi përmes ndërhyrjes, forma, përmbajtja dhe pasojat e pranimit përmes ndërhyrjes, përgjegjësia e pranuesit përmes ndërhyrjes, pagesa përmes ndërhyrjes, kushtet e pagesës përmes ndërhyrjes, të drejtat e personit që paguan përmes ndërhyrjes, pjesët e një seti, pjesët e kopjeve, ndryshimet, kufizimi i veprimeve, ndërprerja e afatit të parashkrimit, fitimi i paligjshëm i pasurisë, e drejta për kolateral dhe mbajtjen e pasurisë, e drejta e mbajtjes së pasurisë, amortizimi i kambialit, protesta, dorëzimi, përmbajtja e protestës, pasojat e protestës së ngritur, Refuzimi i pagesës së shpenzimeve për protestë, dorëzimi i protestës, regjistri i protestave, forma e protestës, konflikti i ligjeve, rregullat që zbatohen për kambialin, verifikimi, ditët e pagesës, vendi i pagesës, premtim - pagesa, përmbajtja dhe

kushtet e premtim-pagesës, dispozitat e kambialit që vlejnë për premtim-pagesat, si dhe dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

Përgjegjësia për zbatimin e ligjit për kambialin është tek ofruesit e kambialit që janë të gjitha institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e instrumenteve të tilla financiare, shfrytëzuesit e kambialit, shërbimi noterial i Republikës së Kosovës, i cili do të jetë përgjegjës për certifikimin e përmbarueshmërisë së kambialit, përmbaruesit privat për shkak se kambiali është dokument i besueshëm në kuptimin e Ligjit për Procedurë Përmbarimore, si dhe gjykatat për rastet e prapësimeve dhe në procedurë kontestimore për kërkesat e siguruara me Kambial.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të ketë përgjegjësi të kufizuar në zbatimin e politikës së Kambialit për shkak se do të jetë përgjegjëse që të përcaktoj formën e Kambialit, që do të përdoret nga institucionet financiare gjatë lëshimit të Kambialit.

Fushata edukuese dhe informuese do të organizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe Odat Ekonomike që veprojnë në Kosovë, vendore dhe të huaja, të cilat do të kenë përdorim të detyrë informimin e anëtarëve të tyre në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit të ri dhe mundësinë e përdorimit të kambialeve për transaksionet e tyre tregtare. Për më tepër, një fushatë nga institucionet financiare që ofrojnë shërbimet e kambialit do të jetë pjesë e fushatës informuese. Ministria e Drejtësisë, në përpjekjet e saj për informim të publikut dhe shfrytëzuesve për politikën e re të Kambialit dhe premtimpagesës, do të përkrahët nga Programi i USAID-it për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial dhe si rezultat, fushata informuese nuk do të ketë ndikim buxhetor në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### *Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit*

Qasja ekzistuese e politikës së kambialit dhe premtim-pagesës është shumë pak e trajtuar në ligjet e aplikueshme, dhe atë në:

1. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve;
2. Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore;
3. Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118.

Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton çështje të ndërlidhura me Kambialin në disa pjesë të tij: Vëllimi i autorizimeve (neni 79),

dhënia e kambialit me qëllim të novacionit (neni 329) dhe fletëpangu pa dëftesë (neni 761). Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcakton kambialin si dokument të besueshëm në bazë të të cilit mund të kërkohet përmbartimi (neni 29), detyrimet e përmbartjes brenda tre ditëve në bazë të kambialit (neni 40 dhe 43) dhe dorëzimi i aktvendimit, si dhe urdhrit përmbartimor (neni 47). Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 përcakton kompetencën gjyqësore për poseduesit e kambialit (neni 50), afatet për përmbartje të premtimit në bazë të aktgjykimit kur është dhënë kambiali (neni 146), afatet e ankesës për aktgjykimet në bazë të kambialit (neni 176) dhe procedurat e dhënies së urdhërpagesës sipas kambialit (neni 493 dhe 495). Përderisa kompetencat e gjykatave dhe organeve përmbartuese, si dhe disa detyrime në lidhje me Kambialin janë të përcaktuara në tre (3) ligjet e theksuara më lartë, çështjet tjera të përfshira, dispozitat e përgjithshme, trajtimin e kambialit, përmbartja e tij, nënshkrimi xhirimi, pranimi, avali, maturimi i kambialit, amortizimi i kambialit, protesta dhe format uniforme të zbrazëta të kambialit dhe premtim-pagesa.

Asnjëri nga këto akte juridike nuk ofron hapësirë të mjaftueshme për t'u plotësuar dhe ndryshuar me qëllim të përfshirjes së rregullativës mbi kambialin dhe premtim pagesën. Për më tepër, ashtu siç është sqaruar në Kapitullin 2: Përvoja nga shtetet tjera, Kambiali dhe premtim pagesa rregullohen me ligje të veçanta. Si rrjedhojë, opsioni i plotësimit dhe ndryshimit të cilitdo nga ligjet aktuale për të përfshirë kambialin dhe premtim pagesën përveç se është i pa përshtatshëm, është në kundërshtim me praktikat aktuale ndërkombëtare.

### *Opsionet tjera*

Opsione tjera nuk ka.

### **Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve**

Përgatisni një tabelë që i përmbledh opsionet duke përdorur formën si më poshtë. Kjo përmbledhje do t'iu ndihmojë të identifikoni informatat që mund të mungojnë ose informatat të cilat do ta bëjnë secilin opsion shumë të qartë për vendimmarrësit.

<b>Përmbledhje e Opsioneve</b>
--------------------------------

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mbetet situatë e njëjtë	Hartimi i ligjit të ri	Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve ekzistuese
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Të gjitha institucionet, Republika e Kosovës, sektori privat	Të gjitha institucionet, Republika e Kosovës, sektori privat	Të gjitha institucionet, Republika e Kosovës, sektori privat
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Në situatën e njëjtë, nuk do të ketë zbatim për shkak se mungon korniza ligjore	Ministria e Drejtësisë, Gjykatat, Noteria, Përmbartimi Privat, Institucionet Financiare dhe sektori privat	Ministria e Drejtësisë, Gjykatat, Noteria, Përmbartimi Privat, Institucionet Financiare dhe sektori privat
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit			
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, si dhe zbatimi dhe dënimet	Mungon korniza ligjore për kambialin dhe premtim pagesën	Hartimi i Ligjit për Kambialin dhe Premtim Pagesën	Ndryshimi i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe Ligjit për Procedurë Përmbartimore
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat	Mungesë e stimulimeve ekonomike në mungesë të një	Krijimi i instrumentit të kambialit dhe premtim pagesës	Krijimi i instrumentit të kambialit dhe premtim pagesës

	instrumenti të shpejtë dhe fleksibil si kambiali.	ndikon në rritjen e qarkullimeve tregtare dhe qasjes në financa duke ofruar stimulim direkt për sektorin privat.	ndikon në rritjen e qarkullimeve tregtare dhe qasjes në financa duke ofruar stimulim direkt për sektorin privat.
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Nuk ka fushatë edukimi dhe komunikimi në mungesë të kornizës ligjore për kambialin dhe premtim pagesën.	Fushatë gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Drejtësisë, Shoqatës së Bankave dhe Odave Ekonomike. Përkrahje financiare për fushatën nga komuniteti i donatorëve (USAID).	Fushatë gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Drejtësisë, Shoqatës së Bankave dhe Odave Ekonomike. Përkrahje financiare për fushatën nga komuniteti i donatorëve (USAID).
Udhëzimet dhe kodet	Nuk zbatohet në mungesë të kornizës ligjore.	Nxjerrja e aktit nënligjor nga Banka Qendrore e Kosovës në lidhje me formën e kambialit.	Nxjerrja e aktit nënligjor nga Banka Qendrore e Kosovës në lidhje me formën e kambialit.
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Në fuqi aktualisht.	Brenda 12 muajve.	Minimalisht 24 muaj për shkak të nevojës për plotësim dhe ndryshim të disa ligjeve.

## **Kapitulli 6: Analiza e opsioneve**

Megjithëse nuk është e mundur që të vlerësohen me siguri përfitimet, pasojat negative dhe kostoja e opsioneve përmes analizës së informatave në dispozicion dhe konsultimit me grupet e prekura, është e mundur që të krijohet pasqyra më e mirë e saktë.

### ***Përfitimet***

1. **Opsioni 1 - *Status quo*.** Status quo nuk është një opsion pasi që politikat e kambialit dhe të premtim pagesës do të mbeten të pa trajtuara dhe këto instrumente do të vazhdojnë të mos ofrohen në Republikën e Kosovës. Për shkak se Kambiali dhe Premtimpagesa janë identifikuar si instrumente të nevojshme për përkrahjen e qarkullimit tregtar në Kosovë dhe ofrimin e qasjes së lehtë dhe të shpejtë në financa, status quo do të pamundësonte arritjen e këtij synimi.
2. **Opsioni 2 - *Hartimi i ligjit të ri*.** Nxjerrja e një ligji të kambialit dhe premtim pagesës në Kosovë do të ndikonte në rritjen e qarkullimeve tregtare në vend, përmes ofrimit edhe të një instrumenti kontraktues për financimin e tregtisë nga institucionet financiare. Ky instrument, i shpejtë dhe efektiv, një letër me vlerë e cila siguron pagesën dhe përdoret për kryerje të pagesave do t'i ofronte ekonomisë kosovare atë që ekonomitë evropiane e shfrytëzojnë qysh nga shekulli XX, me krijimin e një instrumenti uniform përmes Konventës së vitit 1930. Ky sistem, së bashku me shërbimet e noterisë dhe përmbaruesit privat, do të krijonte një hark të shpejtë dhe të sigurt si për blerësit, shitësit ashtu edhe për financuesit (lëshuesit e kambialeve).
3. **Opsioni 3 - *Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve ekzistuese*.** Opsioni i cili përfshinë mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve aktuale, veçanërisht Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk do të ofronte shumë pasoja të ndryshme nga Opsioni 2, mirëpo, duhet pas konsideratë se përpjekjet për ndryshimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe shtimin e pjesës së kambialit dhe premtim pagesës do të mund të marrin shumë kohë, dhe është atipike përfshirja e Kambialit në Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, e cila është në procedurë të hartimit të Kodit Civil, parasheh që dispozitat e marrëdhënieve detyrimore të përfshihen në Kodin Civil, ndërsa Kambiali si instrument financiar kontraktues nuk duhet të jetë pjesë e këtij kodi, për shkak se instrumentet e veçanta financiare nuk janë të parapara të përfshihen në Kod.

### ***Pasojat negative***

1. **Opsioni 1 - Status quo.** Politikat e kambialit dhe të premtim pagesës do të mbeten të pa trajtuara dhe këto instrumente do të vazhdojnë të mos ofrohen në Republikën e Kosovës. Për shkak se Kambiali dhe Premtimpagesa janë identifikuar si instrumente të nevojshme për përkrahjen e qarkullimit tregtar në Kosovë dhe ofrimin e qasjes së lehtë dhe të shpejtë në financa, status quo do të pamundësonte arritjen e këtij synimi.
2. **Opsioni 2 - Hartimi i ligjit të ri.** Hartimi i ligjit të ri dhe ndryshimi i politikës ekzistuese të mos-rregullimit të kambialit dhe premtim pagesës nuk pritet të ketë ndonjë efekt negativ. Kambiali dhe premtim pagesa janë instrumente vullnetare që i ofrohen kërkuesve me qëllim të financimit të transaksioneve dhe sigurimit të pagesës së transaksioneve, dhe si të tilla nuk kanë efekte negative.
3. **Opsioni 3 - Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve ekzistuese.** Ndryshimi i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe shtimi i pjesës së kambialit dhe premtim pagesës do të mund të merr shumë kohë, dhe është atipike përfshirja e Kambialit në Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, e cila është në procedurë të hartimit të Kodit Civil, parasheh që dispozitat e marrëdhënieve detyrimore të përfshihen në Kodin Civil, ndërsa Kambiali si instrument financiar kontraktues nuk duhet të jetë pjesë e këtij kodi, për shkak se instrumentet e veçanta financiare nuk janë të parapara të përfshihen në Kod. Ndryshimi i Ligjit do të krijonte duplikim të punës dhe mungesë të qëndrueshmërisë, për shkak se hartimi i Kodit është në proces, dhe ky Kod do të shfuqizoj dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

### *Efekt i shpërndarës*

Sa i përket efektit shpërndarës, në kuptimin e ndryshimit të përfitimeve dhe pasojave në aspektin e rajoneve të ndryshme ose zonave rurale apo urbane, nuk ka ndonjë ndikim të veçantë për ndonjë rajon apo zonë të veçantë; përkundrazi, përfitimet ose pasojat janë të njëjta për gjithë territorin e Republikës dhe prekin të gjithë sektorët e ekonomisë.

## **Kapitulli 7: Konsultimi**

### *Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, në universitete ose agjenci)*

Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar një konsultim me ekspertët kyç të fushës të së drejtës komerciale në Kosovë dhe ekspertët e institucioneve financiare para përpilimit të këtij koncept dokumenti.

Ekspertët nga Programi për Përmbardim dhe Legjislacion Komercial i USAID-it në Kosovë kanë ofruar përkrahje të drejtpërdrejtë në këtë proces, përfshirë edhe procesin e hartimit të këtij koncept dokumenti dhe ofrimin e zgjidhjeve për krijimin e një ligji për kambialin në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Shoqata e Bankave të Kosovës përmes Komitetit të saj ligjor ka qenë e përfshirë drejtpërdrejtë në proces, ndërsa përfaqësues nga institucioni financiar, Crimson Finance Found, të cilët ndër tjera, kanë përvojë të theksuar në ofrimin e kambialeve në Republikën e Maqedonisë, kanë qenë pjesë e procesit të konsultimeve dhe hartimit të koncept dokumentit.

### *Konsultimi me ministritë e tjera*

- Zyra për Komunikim Publik,
- Sekretariati Koordinues i Qeverisë - ZKM,
- Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM,
- Zyra Ligjore- ZKM,
- Zyra për Qeverisje të Mirë-ZKM,
- Ministria për Financa,
- Ministria për Integritet Evropian,
- Ministria për Administratë Publike,
- Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal,
- Ministria për Komunitete dhe Kthim,
- Sekretariati i Këshillit Konsultativ Për Komunitete,
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### *Konsultimi me akterët - organizatat ose individët që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë*

Komuniteti i biznesit, i cili preket drejtpërdrejtë nga ky ligj është përfshirë në konsultim, përkatësisht përfaqësuesit e tyre në odat ekonomike të vendit. Si rezultat, komuniteti i



biznesit ka qenë i njoftuar në çdo hap dhe do të ketë mundësinë të komunikoj drejtpërdrejtë me palët tjera të interesit në lidhje me këtë ligj.

## **Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)**

**Opsioni 1 - Status quo.** Status quo nuk është një opsion pasi që politikat e kambialit dhe të premtim pagesës do të mbeten të pa trajtuara dhe këto instrumente do të vazhdojnë të mos ofrohen në Republikën e Kosovës. Për shkak se Kambiali dhe Premtim Pagesa janë identifikuar si instrumente të nevojshme për përkrahjen e qarkullimit tregtar në Kosovë dhe ofrimin e qasjes së lehtë dhe të shpejtë në financa, status quo do të pamundësonte arritjen e këtij synimi. Si rezultat, ky nuk është opsioni i rekomanduar.

**Opsioni 2 - Hartimi i ligjit të ri - opsioni i rekomanduar.** Nxjerrja e një ligji të kambialit dhe premtim pagesës në Kosovë do të ndikonte në rritjen e qarkullimeve tregtare në vend, përmes ofrimit edhe të një instrumenti kontraktues për financimin e tregtisë nga institucionet financiare. Ky instrument, i shpejtë dhe efektiv, një letër me vlerë e cila siguron pagesën dhe përdoret për kryerje të pagesave, do t'i ofronte ekonomisë kosovare atë që ekonomitë evropiane e shfrytëzojnë qysh nga shekulli XX, me krijimin e një instrumenti uniform përmes Konventës së vitit 1930. Ky sistem, së bashku me shërbimet e noterisë dhe përmbauesit privat, do të krijonte një hark të shpejtë dhe të sigurt, si për blerësit, shitësit, ashtu edhe për financuesit (lëshuesit e kambialeve). Për shkak se ky opsion do të trajtonte Kambialin dhe Premtimpagesën përmes ligjit të veçantë, ky është opsioni i rekomanduar.

**Opsioni 3 - Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve ekzistuese.** Opsioni i cili përfshinë mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve aktuale, veçanërisht Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nuk do të ofronte shumë pasoja të ndryshme nga Opsioni 2, mirëpo, duhet pas konsideratë se përpjekjet për ndryshimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe shtimin e pjesës së kambialit dhe premtim pagesës do të mund të marrin shumë kohë, dhe është atipike përfshirja e Kambialit në Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë, e cila është në procedurë të hartimit të Kodit Civil, parasheh që dispozitat e marrëdhënieve detyrimore të përfshihen në Kodin Civil, ndërsa Kambiali si instrument financiar kontraktues nuk duhet të jetë pjesë e këtij kodi, për shkak se instrumentet e veçanta financiare nuk janë të parapara të përfshihen në Kod. Ndryshimi i Ligjit do të krijonte duplikim të punës dhe mungesë të

qëndrueshmërisë, për shkak se hartimi i Kodit është në proces, dhe ky Kod do të shfuqizoj dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

### **Kapitulli 9: Rekomandimi**

Qeverisë së Republikës së Kosovës i rekomandohet aprovimi i Koncept Dokumentit dhe autorizimi i Ministrisë së Drejtësisë për të filluar procedurat e hartimit të Ligjit për Kambialin dhe Premtim Pagesën. Ligji i ri do të hartohet në përputhje me Konventën për Ligjin Uniform të Kambialit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke shfrytëzuar sistemet aktuale të noterisë dhe përmbarimit privat, me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të lëshimit, zbatimit dhe përmbarimit të kambialeve në Kosovë. Ministria e Drejtësisë do të formoj grupin e punës me përfshirjen e ekspertëve vendor, organizatave donatore, institucioneve financiare vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të hartimit të projektligjit. Për shkak se Ministria e Drejtësisë do t'i shfrytëzoj resurset e brendshme dhe ekspertizën e donatorëve, ky proces nuk do të ketë implikime buxhetore. Versioni përfundimtar i projektligjit do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës deri më 30 Shtator 2017.

### **Kapitulli 10: Komunikimi**

Fushata edukuese dhe informuese, do të organizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe Odat Ekonomike që veprojnë në Kosovë, vendore dhe të huaja, të cilat do të kenë për detyrë informimin e anëtarëve të tyre në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit të ri dhe mundësinë e përdorimit të kambialeve për transaksionet e tyre tregtare. Për më tepër, një fushatë nga institucionet financiare që ofrojnë shërbimet e kambialit do të jetë pjesë e fushatës informuese. Ministria e Drejtësisë, në përpjekjet e saj për informim të publikut dhe shfrytëzuesve për ligjin e ri të kambialit dhe premtim pagesës, do të përkrahët nga Programi i USAID-it për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial, dhe si rezultat, fushata informuese nuk do të ketë ndikim buxhetor në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Për të arritur grupin e synuar në mënyrë që bizneset të jenë në dijeni për risitë dhe përparësitë që i sjell ligji i ri për kambialin dhe premtim pagesën, Ministria e Drejtësisë do të vendosë një plan veprimi të komunikimit dhe informimit në kuadër të të cilit do të planifikohen aktivitetet për të mbajtur biznesin mirë të informuar. Qëllimi kryesor i planit të veprimit të komunikimit dhe informimit është vetëdijesimi i bizneseve dhe publikut për risitë e ligjit të kambialit dhe premtim pagesës. Ministria do të zhvillojë një varg aktivitetesh me qëllim të arritjes së grupit të synuar, siç janë:

- Njoftimet në mediat dhe spotet televizive;
- Broshurat dhe fletëpalosjet;
- Publikimet e ndryshme; dhe
- Informata në ueb-faqen zyrtare të MD-së.